

# “Mbështetja e Qendrës së Kompetencës së dldp-së në hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 (PBA), Instrumentit të Planifikimit Financiar (FPT), Paketës Fiskale dhe Buxhetit Vjetor”

Bashkitë Kukës, Klos, Lezhë, Malësi e Madhe, Mat, Tropojë dhe Vau i Dejës.

## Konteksti

Projekti synon të mbështes NJQV-të e përzgjedhura në hartimin e programit buxhetor afatmesëm duke i integruar me dokumentet e tyre strategjike; gjithashtu edhe në hartimin e buxhetit vjetor, paketës fiskale si dhe FPT-së.

Qëllimi është forcimi i kapaciteteve të NJQV-ve në menaxhimin e financave publike, në vijim të mbështetjes nga dldp të 6 bashkive (Malësia e Madhe, Tropoja, Mati, Klossi, Kukësi dhe Vau i Dejës) në procesin e hartimit të planeve të tyre strategjike, gjatë vitit 2017; ndërkohë, Bashkia Lezhë është mbështetur nga qeveria qendrore gjatë vitit 2016.

Gjatë hartimit të PBA-së, qeveritë vendore duhet të arrijnë objektivat e tyre strategjike duke harmonizuar politikatat me burimet e tyre financiare të disponueshme, jo vetëm për vitin e ardhshëm por edhe në atë afatmesëm.

## Metodologjia

I tërë procesi i një modeli të planifikimit të buxhetit do të kërkojë shqyrtimin e nevojave të bashkive, me qëllim përmirësimin e standardeve të jetesës të njëjësive më të varfra dhe gjithashtu për ta drejtuar bashkitë në rrugën e zhvillimit ekonomik.

Përgatitja e PBA-së duhet të organizohet si proces transparent i planifikimit të buxhetit për një periudhë tre-vjeçare. Programet do të



klasifikohen siç janë përcaktuar nga Ministria e Financave, duke mundësuar regjistrimin e të gjitha funksioneve që kanë me ligj sot bashkitë, në përkatësisht 29 programe.

IKU do të mbështes 7 bashkitë, përmes Qendrës së Kompetencës së dldp-së në MFP, me trajnime dhe takime për hartimin e Paketës Fiskale, PBA-së, Buxhetit Vjetor si dhe për mënyrën se si të përdorin Instrumentin e Planifikimit Financiar.

## Produkte

Rezultatet e projektit do të jenë 4 trajnime për ekspertët/specialistët e 7 bashkive (Malësia e Madhe, Vau i Dejës, Tropoja, Klos, Kukës, Lezha dhe Mat); 5 takime individuale me secilën bashki; 7 Paketa Fiskale; 7 Instrumente të Planifikimit Financiar; 7 Buxhete Vjetore të lidhur me planet strategjike të bashkive; 7 PBA 2019-2021 të lidhura me planet strategjike të bashkive si dhe marrëveshje dhe dokumente të firmosura nga bashkitë gjatë procesit.

## FAKTET KRYESORE

### DONATOR:

- ✓ dldp/ HIS Albania

### KOHËZGJATJIA:

- ✓ Shkurt 2017 – Dhjetor 2017

### PËRFITUES:

- ✓ Bashkia Kukës
- ✓ Bashkia Klos
- ✓ Bashkia Lezhë
- ✓ Bashkia Malësi e Madhe
- ✓ Bashkia Mat
- ✓ Bashkia Tropojë
- ✓ Bashkia Vau i Dejës

### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14

Hyrja 11, Ap. 56

Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: uri@uri.org.al

web: www.uri.org.al

## Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.